



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 29.01.2018, në orën:11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Shqipe Pantina dhe Fisnik Ismaili.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE, INPO, KDI, BIRN, Koha Ditore dhe RTK-Radio.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës;**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**  
Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës;**

**Nait Hasani**, për pikën e rendit të dites e njoftoi komisionin, që për hartimin e draftligjit për Radio televizionin e Kosovës model do të merret Ligji i transmetuesit publik i Sllovenisë me disa modifikime të tekstit të draftit konform nevojave për Radiotelevizionin e Kosovës-RTK, si p.sh: parapagimi , çështja e pronës, numri i anëtarëve të Bordit të RTK-së, e të tjera.

**Xhevahire Izmaku**, duke e përkrahur diskutimin e kryetarit të Komisionit, ajo propozoi të mbahet një punëtori 2-3 ditore brenda Kosovës dhe të ftohen përfaqësuesit e RTK-së për të dëgjuar ndryshimet e propozuara në hartimin e draftligjit.

**Arban Abrashi**, propozoi që të mbahen disa sesione të punëtorisë dhe në njërën nga të cilat të ftohen përfaqësuesit e Zyrës së BE –së, në Kosovë, përfaqësuesit e EBU-së, përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfaqësuesit e RTK-së dhe grupe të tjera të interesit.

**Imet Rrahmani**, propozoi që të konsultohen të gjithë akterët dhe grupet e interesit me qëllim të shmangemi nga kolizioni i dispozitave ligjore.

**Jasmina Zivkovic**, tha se në tekstin e draftit duhet të ceket me një nen që për RTK-2, kanal in në gjuhën serbe të ndahet një frekuencë, sepse kjo ka qenë e përcaktuar edhe me planin e Ahtisarit.

**Milaim Zeka**, propozoi që në draftligj të përcaktohet që kanali RTK-1, të jetë kanal vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa programet në gjuhën e komuniteteve jo serbe dhe jo shqiptare nga ky kanal të zhvendosen në kanal in RTK-3 dhe RTK-4.

Pas diskutimeve dhe propozimeve për mbajtjen e një punëtorie për hartimin e draftligjit për RTK-në, Komisioni mori vendim si në vijim:

## V E N D I M

1. Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, organizon punëtori për hartimin e draftligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.
2. Punëtorja organizohet nga data 12- 14.02.2018, në Brod, Dragash.
3. Shpenzimet e punëtorisë barten nga buxheti i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën:12:25.

**E përgatiti:**  
**Stafi Mbështetës i Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

-----  
Nait Hasani